



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:041692

Datë: 27.05.2024

Numri i dokumentit: 05735920

CAP.nr.1709/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtaren Halide Reka, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit B.. K... T.. SH.A– Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, kundër debitorëve: M... P... nga fshati C..., Komuna Istog, F... P... nga fshati C..., Komuna Istog, Kompania NTP "K... F...", me seli në fshatin B..., Komuna Istog e përfaqësuar nga pronari M... P..., Kompania NTP "K... W..." me seli në fshatin B..., Komuna Istog përfaqësuar nga pronari F... P..., për shkak të përmbarimit të kërkesës në të holla - borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.4/2023 të datës 13.10.2023, jashtë seance me datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e debitorit M... P... nga fshati C..., Komuna Istog, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, PPP.nr.4/2023 të datës 13.10.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Istog, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.4/2023 të datës 13.10.2023, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit F... P..., me adresë banimi fshati C..., Komuna Istog, i parashtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.275/22 të datës 12.12.2022 , nga Përmbaruesi Privat Zija Bala në Pejë. Në pikën II të dispozitivit e ka lënë në fuqi Urdhrit e Përmbaruesit Privat P.nr.275/22 të datës 12.12.2022.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar debitori, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale, zbatimit të gabuar të dispozitave materiale dhe konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të shfuqizohet Urdhri Përmbarimor P.nr.275/22 i datës 12.12.2022 i lëshuar nga Përmbaruesi Privat Zija Bala.

Përgjigje në ankesën e debitorit ka paraqitur pala kreditore, me propozim që ta refuzoj ankesën si të pa bazuar dhe të pa argumentuar ligjërisht dhe të konfirmoj/ vërtetoj urdhrin përmbartimor P.Nr.275/22 të datës 12.12.2022 të lëshuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, me të cilin është lejuar përmbartimi i kolateralit të kredisë së debitorëve të lartshënuar.

Gjykata e Apelit, përmes gjyqtarës individuale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezultonte kreditori B.. K... T.. SH.A – Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, ka paraqitur propozim për përmbartim kundër, debitorëve: M... P..., nga fshati C..., Komuna Istog, F... P..., nga fshati C..., Komuna Istog, Kompania NTP "K... F...", me seli në fshatin B..., Komuna Istog, përfaqësuar nga pronari M... P..., Kompania NTP "K... W..." me seli në fshatin B..., Komuna Istog, përfaqësuar nga pronari F... P..., në bazë të dokumenteve përmbartimore, Marrëveshjes mbi Pengun e lidhur me datë 20.12.2017 me Nr.7201516857 që është Shtojca 1 e Kontratës së Kredisë Bankare nr. 7201516857, me të cilën figuron se debitorët i detyrohen kreditorit në borxh në shumën prej 7,837.93 Euro.

Përmbartuesi Privat, Zija Bala duke vepruar në bazë të propozimit për përmbartim të kreditorit, me urdhrin P.nr.275/22 të datës 12.12.2022, ka lejuar përmbartimin. Kundër urdhrin për përmbartim palët debitorë përmes përfaqësuesit të tyre, brenda afatit ligjor kanë paraqitur prapësim me të cilin kanë theksuar se me asnjë provë nuk dëshmohet pranimit i këtyre faturave nga debitorit, kreditori propozimit ia ka bashkangjitur disa dokumente të nxjerra nga sistemi i vet të cilat mundohet ti paraqes një situatë hipotetikë të detyrimit e cila nuk vërtetohet me asnjë faturë përcjellëse, po ashtu debitorit ka bërë kërkesë të kreditorit më të cilën ka kërkuar që t'iu zvogëlohet shuma mujore e këstit në 300 euro për shkake të vështirësive financiare dhe inflacionit, debitorit e ka paguar shumën me të madhe dhe as që tenton tu shmanget përgjegjësisë por për shkak së gjendet në vështirësi financiare është përgjigjur se për të bërë një gjë të tillë shuma e detyruar duhet brenda mundësive të realizimit dhe i lutet kreditorit që shuma e këstit të zvogëlohet për një periudhë një vjeçare. Kreditori në afatin e paraparë ligjor me datën 29.12.2022 ka paraqitur përgjigje në prapësim në të cilin ka theksuar e kundërshton në tërësi prapësimin e debitorit pasi që përmbartimi nuk është caktuar sipas dokumentit të besueshëm-faturë, por urdhri për përmbartim është caktuar sipas propozimit të kreditorit në bazë të Marrëveshjes për pengun e regjistruar në regjistrin e pengut e cila paraqet titull ekzekutiv dhe është përcaktuar me ligj si dokument përmbartimor.

Gjykata e shkallës ë parë duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit ka nxjerrë aktvendimin e ankimuar PPP.nr.4/2023 të datës 13.10.2023, me

të cilin e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar prapësimin e debitorit , e duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se Marrëveshja mbi Pengun e lidhur me datë 20.12.2017 që është Shtojca 1 e Kontratës së Kredisë Bankare nr. 7201516857, është dokument përmbartimor ngase me Ligjin Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, përkatësisht në nenin 5 paragrafi i 2-të thotë : “ *Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1., pas nën-paragrafit 1.7., shtohet nën-paragrafi i ri 1.7a. me tekstin si në vijim. 1.7a. kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut* “dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: “*Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Marrëveshja mbi Pengun e lidhur me datë: 20.12.2017 që është Shtojca 1 e Kontratës së Kredisë Bankare nr. 7201516857, e cila është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në Zyrën e Regjistrimit të Pengut, R- 20171228-316 siguron të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Kontrata e Kredisë Bankare nr. 7201516857, të datës 20.12.2017.

Pretendimet e debitorit për zbatim të gabuar të së drejtës materiale nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit, sepse në procedurën përmbartimore gjykata e shkallës së parë në bazë të provave dhe shkresave të lëndës, drejtë ka konstatuar gjendjen faktike, pasi që debitori me anë të prapësimit nuk ka sjellë asnjë provë të vetme për të argumentuar të kundërtën. Po ashtu gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për prapësimin vendos duke iu përmbajtur parimit të rigozitetit formal-juridik, që nënkupton se gjykata do të vlerësojë shkaqet për prapësim por nuk mund të lëshohet në vlerësimet tjera që i përkasin procedurës në të cilën është nxjerr dokumenti përmbartimor.

Pretendimin e debitorit se *shkak i mos pagesës së obligimeve ndaj kreditorit ka qenë gjendja e vështirë financiare dhe kjo është arsyeja e vetme se pse nuk ka paguar me rregull ratat e kredisë, por në të ardhmen sigurisht se do ti paguaj me rregull sipas marrëveshjes së paraparë* nuk janë pranuar nga Gjykata e Apelit për arsye se kreditori obligimet që rrjedhin nga Kontrata e Kredisë Bankare nr. 7201516857, të datës 20.12.2017 i ka siguruar me Shtojcën 1: Marrëveshja mbi Pengun e lidhur me datë 20.12.2017, në rast se debitori dështon të paguaj obligimet e tij nga të ardhurat e tij financiare apo ndonjë rrjedhojë tjetër, obligimet do të kthehen nga garantuesit ose kolaterali i lënë peng në bazë të Listës së Pengut.

Lidhur me pretendimin e debitorit se kreditorit i ka skaduar afati kohor brenda të cilit sipas ligjit mund të kërkohet përmbartimi nuk qëndron sepse në bazë të nenit 349 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve NR. 04/L-077 është përcaktuar se: “*Kur të ketë kaluar afati i parashkrimit, kreditori kërkesa e të cilit është e siguruar me peng ose me hipotekë, mund të paguhet vetëm nga sendi i ngarkuar, në qoftë se e mban në dorë apo në qoftë se e drejta e tij është regjistruar në regjistrat publik*”. Në këtë rast kreditori kërkesën e tij e ka të siguruar me peng në bazë të Marrëveshjes së Pengut nr. 7201516857, të datës 20.12.2017, e cila është e regjistruar në Zyrën për Regjistrim të Pengut- Konfirmimi i Regjistrimit të Pengut R-20171228-316, po ashtu në bazë të nenit 132 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr. 03/L-154 lidhur me kërkesat

e siguruara thuhet : *“Një e drejtë sendore e sigurimit mund të ushtrohet edhe atëherë, kur kërkesa e siguruar është parashkruar”*.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të ligjshëm, prandaj përfundimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e për të cilat shkaqe ankimore Gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.1709/2023, datë 27.05.2024

Gjyqtarja
Halide Reka